LIGJ
Nr. 90/2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat e organizimit e të funksionimit, detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akreditуar nga Bashkimi Evropian, më poshtë Agjencia.

Neni 2

Misioni

1. Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, për fondet para dhe pas anëtarësimit.

2. Agjencia, nëpërmjet auditimeve, ofron siguri lidhur me sistemet e drejtimit, kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm, mbikëqyrjes, kontabilitetit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, marrëveshjet kuadër, rregulloret e aplikueshme të Bashkimit Evropian dhe Strategjinë e Auditimit të Agjencisë.

Neni 3
Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim të përcaktojë dispozitat e nevojshme që sigurojnë pavarësinë e nevojshme funksionale dhe financiare të Agjencisë, e cila vepron si autoriteti auditues i Instrumentit të Paraanëtarësimit IPA.

Neni 4
Fusha e veprimit

1. Veprimtaria e Agjencisë kryhet në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve kuadër IPA dhe të çdo marrëveshjeje tjetër sektoriale dhe/ose financiare në zbatim të marrëveshjeve kuadër.

2. Auditimet e Agjencisë mbulojnë fushat e pajtueshmërisë, ligjshmërisë e të rregullshmërisë, menaxhimin financiar të fondeve të BE-së, si dhe ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve në përputhje me konceptet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

3. Agjencia në veprimtarinë e saj pasqyron standardet më të larta ndërkombëtare të organizatave INTOSAI dhe IFAC, si dhe rezolutat e kongreseve të organizatave INTOSAI dhe EUROSAI.

4. Subjekt i auditimeve të Agjencisë janë të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, individë dhe persona juridikë privatë që përfitojnë fonde të IPA-s dhe/ose të cilëve u kërkohet të kryejnë

veprimtari që rrjedhin nga financimi i IPA-s. Këtu përfshihen:

a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike;

b) përfituesit e drejtpërdrejtë dhe indirekt të fondeve IPA;

c) shoqëritë shtetërore, organizatat jo-fitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;

ç) njësitë e qeverisjes vendore;

d) individët dhe personat juridikë privatë.

5. Në rast se gjatë ushtrimit të kompetencave të auditimit të Agjencisë lindin çështje, që nuk rregullohen me këtë ligj, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 5

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Auditim" është auditimi i kryer nga Agjencia, i cili përfshin auditimin e përputh-shmërisë, të sistemit, të operacioneve, auditimin financiar, auditimin e performancës, të IT-së dhe auditimin e kombinuar. Auditimet kryhen sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe standardeve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

2. "Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës të BE-së", në vijim "Agjencia", është autoriteti i auditimit, i krijuar në përputhje me marrëveshjet përkatëse kuadër, të nënshkruara ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, si një agjenci autonome, funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët e sistemeve të menaxhimit e të kontrollit në alokimin dhe përdorimin e fondeve të Bashkimit Evropian.

3. "Auditues i agjencisë" është çdo punonjës i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së BE-së, që kryen aktivitetin e auditimit të jashtëm të sistemeve të implementimit të asistencës së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë.

4. "Fondet e BE-së" përfshijnë asistencën në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (këtu e më poshtë referuar si IPA) dhe çdo asistencë tjetër që i jepet Republikës së Shqipërisë nga Bashkimi Evropian.

5. "Marrëveshje kuadër" është çdo marrëveshje e lidhur midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për mbështetjen financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të asistencës, nën Instrumentin e Asistencës së Paraanëtarësimit ose çdo instrumenti tjetër të mbështetjes, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

6. "Marrëveshje sektoriale" është çdo marrë-veshje e lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për mbështetjen financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të asistencës në fushën e bujqësisë e të zhvillimit rural (IPARD) nën Instrumentin e Asistencës së Paraanëtarësimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ose i ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

7. "Marrëveshje financimi" është çdo marrë-veshje e lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si përfitues IPA II, dhe Komisionit të Komunitetit Evropian, kur kërkohet vendimi financues përkatës, në të cilën përcaktohen, ndër të tjera, kushtet e menaxhimit të asistencës IPA II, përfshirë metodat e zbatimit, intensiteti i ndihmës, afatet e zbatimit, si dhe rregullat për pranueshmërinë e shpenzimeve.

8. "Zyrtari Kombëtar i Autorizuar" (më poshtë referuar si ZKA) është mbajtësi i funksionit të caktuar publik, i emëruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përgjegjës për menaxhimin financiar të fondeve të Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë dhe funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit në përputhje me kërkesat dhe rregulloret e përcaktuara nga Komisioni Evropian.

9. "Koordinatori Kombëtar i IPA-s" është mbajtësi i funksionit të caktuar publik, i emëruar

nga Republika e Shqipërisë, i cili është homologu kryesor i Komisionit Evropian për procesin e përgjithshëm të planifikimit strategjik, koordinimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA.

10. "Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit" është mbështetja financiare e paraanëtarësimit në Bashkimin Evropian që u jepet vendeve kandidate dhe vendeve kandidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian (në vijim IPA).

11. "Subjekt auditimi" është çdo institucion publik, person fizik dhe juridik, përfitues direkt apo indirekt i fondeve të Bashkimit Evropian, shoqëritë publike, shoqëritë private, si dhe subjekte të tjera juridike, të krijuara nga përfituesit direkt apo indirekt të financimit të Bashkimit Evropian.

12. "Raport vjetor i aktiviteteve audituese" është raporti i Agjencisë, sipas kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen kuadër IPA përkatëse.

13. "Opinion vjetor i auditimit" është opinioni i përgatitur nga Agjencia, sipas kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen kuadër IPA përkatëse.

14. "Opinion vjetor i auditimit për llogaritë dhe deklaratën e shpenzimeve" është opinioni i përgatitur nga Agjencia, sipas kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen kuadër IPA përkatëse mbi llogaritë dhe deklaratën e shpenzimeve, të paraqitur nga Zyrtari Kombëtar i Autorizuar për fondet e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit për zhvillimin rural.

15. "Opinion i auditimit për deklaratën përfundimtare të shpenzimeve" është opinioni i përgatitur nga Agjencia, sipas kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen kuadër IPA përkatëse për deklaratën përfundimtare të shpenzimeve, të paraqitur nga Zyrtari Kombëtar i Autorizuar për mbylljen e një programi ose të një pjese të tij.

16. "Zyrtari përgjegjës akreditues" është mbaj-tësi i funksionit të caktuar publik, i emëruar nga Republika e Shqipërisë, përgjegjës për dhënien, monitorimin, pezullimin apo bllokimin e akreditimit të Zyrtarit Kombëtar të Autorizuar. Ky pozicion vlen vetëm për periudhën e programimit IPA I (2007–2013), sipas marrëveshjes kuadër IPA I, nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian më 18.7.2007.

17. "Standardet e auditimit" është tërësia e koncepteve, udhëzimeve, parimeve, procedurave dhe udhëzuesve metodikë për trupën audituese në procesin e auditimit.

18. "INTOSAI" është Organizata Ndër-kombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit që miraton standardet profesionale të etikës e të pavarësisë që duhet të ndiqen nga institucionet supreme të auditimit (SAI).

19. "EUROSAI" është organizmi rajonal i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. EUROSAI është organizatë e pavarur, jopolitike, e cila nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve, përvojave e të qasjeve të auditimit ndërmjet institucioneve supreme të auditimit.

20. "AFCOS" është Shërbimi i Koordinimit të Antimashtrimit, i caktuar në Shqipëri për të lehtësuar bashkëpunimin me organet e Bashkimit Evropian.

21. "IFAC" është Federata Ndërkombëtare e Kontabilitetit, e cila është organizatë ndër-kombëtare në fushën e kontabilitetit që ofron ndihmë për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

22. "OLAF" është Zyra Evropiane kundër Mashtrimit.

KREU II
KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS SË BE-SË

Neni 6
Statusi i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së BE-së

1. Agjencia është person juridik publik, buxhetor, i organizuar në formën e agjencisë autonome, nën mbikëqyrjen e Kryeministrit.

2. Agjencia është organi i caktuar për auditimin e jashtëm të asistencës së Bashkimit Evropian

për Republikën e Shqipërisë.

3. Agjencia e kryen veprimtarinë e pavarur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s, Zyrtari Kombëtar i Autorizuar, strukturat menaxhuese dhe strukturat operuese të asistencës së Bashkimit Evropian.

4. Numri i punonjësve, struktura organizative dhe nivelet e pagave të Agjencisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Agjencia është një organ i depolitizuar dhe i departizuar.

Neni 7

Selia, stema dhe vula

1. Selia e Agjencisë ndodhet në Tiranë.

2. Stema dhe vula e Agjencisë propozohen nga drejtori dhe miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Stema është një kombinim i stemës shtetërore të Republikës së Shqipërisë me objektin e punës së Agjencisë, si auditues i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian.

Neni 8

Funksionet e Agjencisë

1. Agjencia përmbush funksionin dhe qëllimin e saj në përputhje me marrëveshjet kuadër, të nënshkruara ndërmjet palëve të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë, rregulloret për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve të BE-së të Komisionit Evropian, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe manualet e udhëzuesit e Agjencisë.

2. Agjencia mund të mbështetet në punën e audituesve të tjerë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara të auditimit.

3. Agjencia ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) harton, nën përgjegjësinë e drejtorit, Stra-tegjinë e Auditimit për periudhën 3-vjeçare, duke përcaktuar metodologjinë, metodat e përzgjedhjes që do të zbatohen për auditimet e operacioneve e të transaksioneve, si dhe për planifikimin e auditimeve;

b) dorëzon Strategjinë e Auditimit për tri vitet e ardhshme, brenda muajit nëntor të çdo viti, pranë Komisionit Evropian, duke informuar njëkohësisht Zyrtarin Kombëtar të Autorizuar;

c) dorëzon pranë Komisionit Evropian, si dhe pranë autoriteteve vendase përkatëse planin vjetor të punës audituese ose çdo raport tjetër të specifikuar në marrëveshjen kuadër përkatëse;

ç) kryen veprimtari audituese me qëllim veri-fikimin e:

i) plotësisë, saktësisë dhe vërtetësisë së raporteve dhe pasqyrave/deklaratave financiare vjetore, si dhe të llogarive vjetore që mbështetin këto pasqyra /deklarata;

ii) funksionimit efektiv të sistemeve të mena-xhimit, kontrollit e të mbikëqyrjes;

iii) ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve përkatëse;

d) harton dhe paraqet strategjitë e auditimit, raportet vjetore të aktivitetit të auditimit dhe opinionet vjetore të auditimit pranë Komisionit Europian dhe Këshillit të Ministrave, duke informuar njëkohësisht institucionet dhe organet kompetente, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 9

Buxheti

1. Burimet e financimit të Agjencisë përfshijnë:

a) Buxhetin e Shtetit;

b) të ardhura të tjera të krijuara nga kryerja e veprimtarisë së Agjencisë në zbatim të këtij ligji;

c) të ardhura nga projekte, hua ose donacione, të marra në përputhje me legjislacionin që

rregullon fushën përkatëse dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Programi buxhetor vjetor e afatmesëm përgatitet dhe miratohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rast të mospërputhjeve të kërkesave buxhetore ndërmjet Agjencisë dhe ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim sigurimin e pavarësisë financiare, Agjencia mund t'i drejtohet Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë.

4. Projektbuxheti vjetor i Agjencisë përgatitet nga drejtori i përgjithshëm dhe, pasi miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i dërgohet ministrisë përgjegjëse për financat.

5. Buxheti vjetor i Agjencisë përdoret në mënyrë të pavarur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor dhe financiar në Republikën e Shqipërisë.

6. Gjatë vitit financiar, drejtori i përgjithshëm mund të propozojë ndryshime në buxhetin e miratuar vjetor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

7. Agjencia përgatit çdo vit pasqyrat financiare vjetore në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Pasqyrat financiare vjetore i paraqiten Këshillit Mbikëqyrës si pjesë e raportit të veprimtarisë vjetore dhe mbulojnë një vit kalendarik.

8. Veprimtaria e Agjencisë auditohet vetëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raportet e auditimeve me përfundimet dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit i dërgohen Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë dhe Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian të Kuvendit të Shqipërisë.

Neni 10

Drejtimi i Agjencisë

1. Struktura drejtuese e Agjencisë përbëhet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe drejtori i përgjithshëm.

2. Këshilli Mbikëqyrës siguron funksionimin efektiv dhe të efektshëm të sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm në Agjenci.

3. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë, të emëruar për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, si më poshtë:

a) Kryetari dhe një anëtar propozohen nga Kryeministri, njëri prej të cilëve përzgjidhet nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë;

b) një anëtar propozohet nga komisioni parlamentar përgjegjës për integrimin evropian.

4. Përfaqësuesit e ministrive të linjës, strukturave IPA ose organizatave të tjera që aplikojnë për ose janë përfitues të fondeve IPA, nuk mund të jenë pjesë e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë.

5. Roli i sekretariatit teknik të Këshillit Mbikëqyrës kryhet nga Agjencia.

6. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për veprimtarinë, emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë.

Neni 11

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

a) miraton programet e punës vjetore dhe strategjike të Agjencisë pas mendimit të strukturave përkatëse në Komisionin Evropian;

b) me propozimin e drejtorit të përgjithshëm miraton buxhetin e Agjencisë;

c) miraton projektstrukturën organizative dhe bën propozimin për nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë, të paraqitura nga drejtori i përgjithshëm;

ç) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave të Agjencisë;

d) monitoron funksionimin e Agjencisë;

dh) ushtron kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

e) merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Për t'u emëruar anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, personat duhet të plotësojnë këto kërkesa:

a) të kenë shtetësi shqiptare;

b) të kenë përfunduar studimet e larta universitare të ciklit të dytë të studimeve, "Master i shkencave" ose ekuivalente me të në shkencat ekonomike ose juridike;

c) të kenë të paktën 7 vjet përvojë pune. Kandi-dati, që do të propozohet nga Organizata Profesi-onale e Audituesve Ligjorë, të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë në fushën e auditimit;

ç) të jenë me integritet moral dhe profesional;

d) të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;

dh) të mos jenë larguar me masë disiplinore nga shërbimi civil;

e) të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

ë) të mos ketë për ta kushte të tjera ndaluese, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 13

Drejtori i Agjencisë

1. Drejtori është titullari i Agjencisë.

2. Përveç kritereve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, Drejtori i Agjencisë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkencat ekonomike ose juridike;

b) të ketë të paktën 15 vjet përvojë profesionale, nga të cilat të paktën 9 vjet në fushën e auditimit të jashtëm dhe/ose të brendshëm publik;

c) të gëzojë integritet të lartë, moral e profesional;

ç) të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze, i certifikuar nga institucione publike të arsimit të lartë ose nga subjekte të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

Neni 14

Përzgjedhja dhe emërimi i drejtorit të Agjencisë

1. Drejtori emërohet sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil dhe është pjesë e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, drejtori i Agjencisë ka pavarësi në lidhje me dhënien e opinioneve, hartimin e raporteve, paraqitjen e gjetjeve të auditimit dhe rekomandimeve përkatëse.

Neni 15

Papajtueshmëritë me detyrën e drejtorit të Agjencisë

1. Funksionet e drejtorit të Agjencisë janë të papajtueshme me:

a) punësimin në një organ të administratës shtetërore ose pranë një personi privat, të cilit i janë deleguar funksione të organeve të administratës shtetërore;

b) anëtarësinë, veprimtarinë ose ushtrimin e funksioneve në partitë politike;

c) ushtrimin e funksionit në kushtet e mos-respektimit të kufizimeve të vendosura nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;

ç) angazhimin në detyra të tjera që mund të ndikojnë negativisht në besimin, paanësinë dhe reputacionin e Agjencisë në përgjithësi, si dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës e të punonjësve në veçanti.

2. Drejtori i Agjencisë nuk mund të ushtrojë veprimtari tjetër, me përjashtim të

mësimdhënies, veprimtarive kërkimore-shkencore apo pjesë-marrjes në organizata vendase ose ndërkombëtare, që kanë lidhje me veprimtarinë e Agjencisë dhe që nuk ndikojnë në paanshmërinë dhe pavarësinë e pozicionit të drejtorit të Agjencisë.

3. Drejtori i Agjencisë nuk mund të marrë pjesë dhe nuk mund të marrë vendime në procesin e auditimit, nëse ka qenë i punësuar nga organi, i cili është subjekt i auditimit, ose nëse ka kryer detyra të caktuara për atë subjekt, në rast se nuk ka kaluar një periudhë prej pesë vjetësh nga ndërprerja e punësimit ose nga përfundimi i detyrave.

Neni 16

Përgjegjësitë e drejtorit

1. Drejtori i Agjencisë ushtron detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

a) harton dhe i paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës dokumentet strategjike dhe të planifikimit të auditimit;

b) harton metodologjinë e auditimit dhe propozon ndryshimin e mëtejshëm të kësaj metodologjie, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe udhëzimet e Bashkimit Evropian;

c) siguron kryerjen e auditimeve në bazë të metodologjive të përcaktuara dhe në përputhje me standardet INTOSAI dhe IFAC, sipas rastit;

ç) siguron kryerjen e auditimeve në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;

d) mbikëqyr zbatimin e rregullave e të procedurave për parandalimin e konfliktit të inte-resit;

dh) përgjigjet për hartimin e sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm, në përputhje me praktikat më të mira në fushën e auditimit;

e) monitoron sistemet e qeverisjes e të kontrollit të brendshëm për të siguruar që këto sisteme të funksionojnë në mënyrë efektive;

ë) harton raportin vjetor të veprimtarisë, i cili mbulon aktivitetet e Agjencisë gjatë vitit raportues dhe përfshin raportimin mbi funksionimin efektiv të sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm;

f) përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët;

g) paraqet projektbuxhetin vjetor pranë Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë;

gj) i propozon Këshillit Mbikëqyrës projekt-strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë;

h) kryen vlerësimin e performancës së stafit, sipas kërkesave të ligjit për nëpunësin civil;

i) paraqet për miratim te Këshilli Mbikëqyrës rregulloren e brendshme të funksionimit dhe administrimit të Agjencisë;

j) përcakton dhe paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës kërkesat për çdo pozicion pune, kriteret e punësimit të personelit, në për-puthje me legjislacionin në fuqi dhe me rregulloren e tij të brendshme;

k) emëron personelin e nevojshëm admini-strativ, sipas kritereve të përcaktuara, dhe mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit;

l) ushtron detyra të tjera të përcaktuara me ligj ose rregullore të Komisionit Evropian.

2. Drejtori i Agjencisë përgatit një raport vjetor mbi veprimtarinë dhe drejtimin e Agjencisë, i cili paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Mbikëqyrës brenda muajit shkurt të çdo viti.

3. Drejtori i Agjencisë është objekt i detyrimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil dhe Kodin e Etikës të Agjencisë në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e detyrave publike.

Neni 17

Zëvendësdrejtori i Agjencisë

1. Drejtori i Agjencisë mbështetet nga një zëvendësdrejtor.

2. Drejtori mund t'i delegojë detyra apo përgjegjësi zëvendësdrejtorit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nuk mund të delegohen të drejtat dhe detyrat, për të cilat ndalohet shprehimisht delegimi në këtë ligj apo në ligje të tjera.

3. Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e drejtorit të Agjencisë dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjshmëria për realizimin e detyrave përkatëse.

4. Kur drejtori i Agjencisë mungon ose është në pamundësi për të vepruar, zëvendësdrejtori drejton Agjencinë për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij.

5. Zëvendësdrejtori, përveç kritereve të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkencat ekonomike ose juridike;

b) të ketë të paktën 7 vjet përvojë profesionale në auditim;

c) të gëzojë integritet të lartë moral e profesional;

ç) të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze, i certifikuar nga institucione publike të arsimit të lartë ose nga subjekte të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

6. Rastet e papajtueshmërisë me funksionin e drejtorit të Agjencisë, të parashikuara në nenin 15, të këtij ligji, zbatohen edhe për zëvendësdrejtorin e Agjencisë.

7. Zëvendësdrejtori i Agjencisë është objekt i detyrimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil dhe Kodin e Etikës të Agjencisë, në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin detyrave publike.

8. Në rastet kur zëvendësdrejtori identifikon ndonjë papajtueshmëri gjatë ushtrimit të detyrës, informon menjëherë drejtorin e Agjencisë dhe Këshillin Mbikëqyrës.

Neni 18

Stafi i Agjencisë

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së puno-njësve administrativë rregullohen sipas para-shikimeve të Kodit të Punës.

2. Përveç kritereve të përgjithshme, të para-shikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, audituesi i Agjencisë duhet të përmbushë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) të ketë diplomë universitare "Master i shkencave" ose ekuivalente me të në fushën e shkencave ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;

b) të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion;

c) të zotërojë kualifikime dhe/ose certifikime profesionale të akredituara në fushën e auditimit ose të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune në auditim;

ç) të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze, i certifikuar nga institucione publike të arsimit të lartë ose nga subjekte të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

3. Punonjësve të Agjencisë nuk u lejohet të jenë anëtarë të ndonjë organizate apo partie politike dhe ata nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike ose me karakter tregtar, përveç aktiviteteve të kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe veprimtarive kulturore apo sportive, me kusht që këto aktivitete të mos dëmtojnë reputacionin e Agjencisë dhe të mos cenojnë paanshmërinë e pavarësinë e tij.

4. Punonjësit e Agjencisë duhet të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe në

përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, legjislacionin për shërbimin civil, rregulloren e brendshme të institucionit, standardet e auditimit dhe Kodin e Etikës.

5. Funksionet e financave, shërbimeve juridike, menaxhimi i burimeve njerëzore, shërbimeve të brendshme mbulohen nga stafi i Agjencisë.

Neni 19

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Punonjësit e Agjencisë gëzojnë të drejtën për t'u trajnuar profesionalisht, sipas planifikimeve të bëra nga institucioni, në përputhje me nevojat e evidentuara.

2. Agjencia siguron një proces sistematik dhe të planifikuar të trajnimit, zhvillimit profesional dhe/ose certifikimit, i cili përfshin shtimin dhe përditësimin e njohurive e të aftësive të nevojshme për kryerjen me efektivitet të detyrave të auditimit, në bashkëpunim me ASPA-n, me institucione të tjera të larta të auditimit apo me organizata profesionale, vendase apo ndërkombëtare.

3. Kohëzgjatja e trajnimeve të detyrueshme përcaktohet në manualin e auditimit dhe rregulloren e brendshme të Agjencisë.

Neni 20

Parimet e ushtrimit të detyrës së audituesve

1. Në ushtrimin e detyrës së tyre, punonjësit e Agjencisë duhet të jenë të pavarur dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë kufizimi apo presioni në lidhje me mendimet e tyre.

2. Marrëdhënia profesionale ndërmjet tyre dhe subjekteve të audituara duhet të bazohet në ndershmërinë, integritetin, korrektësinë, konfidencialitetin dhe pavarësinë nga subjekti i audituar, në përputhje me legjislacionin për para-ndalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe Kodin e Etikës të Audituesve.

3. Gjatë kryerjes së detyrave dhe kompetencave të tyre, punonjësit e Agjencisë nuk duhet të kërkojnë e as të pranojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për vete ose për personat e tjerë, dhurata apo përfitime të tjera.

4. Përgjegjësia disiplinore e nëpunësve të Agjencisë rregullohet nga legjislacioni për shërbimin civil, Kodi i Etikës dhe rregullorja e brendshme e Agjencisë.

5. Stafi profesional audites i Agjencisë ka të drejtë të shprehë gjykimin profesional në lidhje me opinionet, gjetjet apo raportet e auditimit, të cilat do të konsiderohen si pjesë e proceseve të auditimit të Agjencisë.

6. Në rast se një punonjës i Agjencisë është në kushtet e një kërcënimi apo kanosjeje gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese njofton menjëherë drejtorin e Agjencisë. Rregullat edhe procedura më të detajuara për ndjekjen e këtyre rasteve rregullohen në rregulloren e brendshme të Agjencisë.

Neni 21

Konfliktet e interesit

1. Të gjithë punonjësit e Agjencisë janë të detyruar:

a) të njohin rastet që përbëjnë konflikt interesi në lidhje me detyrat e tyre profesionale;

b) të rishikojnë qëndrimin e tyre gjatë ushtrimit të funksionit si audites në lidhje me konfliktet e mundshme të interesit dhe të deklarojnë çdo konflikt të mundshëm te zëvendësdrejtori i Agjencisë gjatë pjesëmarrjes në planifikimin e veprimtarisë audituese;

c) të nënshkruajnë një deklaratë përpara çdo misioni auditimi për ekzistencën ose jo të shkaqeve që përbëjnë konflikt interesi me ushtrimin e funksionit të audituesit.

2. Zëvendësdrejtori duhet të japë informacione shpjeguese menjëherë për çdo konflikt interesi që lind pas fillimit të pjesëmarrjes nga ana e audituesve gjatë kryerjes së auditimit.

3. Punonjësit e Agjencisë nuk kanë të drejtë që të marrin pjesë në një detyrë të auditimit nëse:

a) kanë qenë punësuar nga të audituarit ose kanë qenë përfaqësues ligjorë të të audituarit,

brenda një periudhe pesëvjeçare para fillimit të detyrës si audituesi;

b) bashkëshorti/bashkëshortja apo bashkë-jetuesi ose të afërmit deri në shkallë të dytë, sipas përcaktimeve të bëra nga Kodi Civil, kanë qenë të punësuar në tri vitet e fundit si autoritete menaxhuese ose mbikëqyrëse në subjektet e auditimit;

c) audituesi, bashkëshorti/bashkëshortja, të afërmit deri në shkallë të dytë sipas përcaktimeve të Kodit Civil, janë aksionarë, ortakë, anëtarë të këshillave drejtues apo themeluesit e subjektit të audituar ose kanë një marrëdhënie të ngjashme me një grup aksionarësh.

Neni 22

Bashkëpunimi

1. Agjencia ka detyrimin e bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane të Audituesve, si dhe me organet përkatëse të Komisionit Evropian. Ky detyrim përfshin të drejtën e aksesit në dokumentacionin dhe dosjet e auditimit, si dhe mbi qasjet profesionale të stafit audituesi.

2. Në rast se Gjykata Evropiane e Audituesve dhe/ose organet përkatëse të Komisionit Evropian kanë kryer rishikim të auditimeve dhe kanë bërë rekomandime për përmirësimin e auditimeve të kryera nga Agjencia, drejtori i Agjencisë ka përgjegjësinë për të siguruar zbatimin e rekomandimeve.

3. Drejtori i Agjencisë informon Këshillin Mbikëqyrës për pranimin dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

4. Agjencia bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet audituese të vendeve të tjera të paraanëtarësimit ose shteteve anëtare. Ky bashkë-punim konsiston në pjesëmarrje në forume të krijuara për të shkëmbyer përvojat, kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, pjesëmarrje në aktivitete rajonale.

5. Agjencia mund të marrë pjesë në analiza profesionale në bashkëpunim me autoritetet e tjera të auditimit.

6. Në çdo rast bashkëpunimi, Agjencia përfaqëson dhe mbron interesat e Republikës së Shqipërisë.

7. Agjencia mund të veprojë si pjesë e grupeve të auditimit, që ngrihen për auditimin e programeve ndërkufitare të financuara nga Komisioni Evropian. Për programet e bashkëpunimit territorial të financuara nga BE-ja, në të cilat merr pjesë Republika e Shqipërisë, Agjencia cakton përfaqësuesit e saj në grupin e audituesve të secilit prej programeve. Në këto raste, Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e kërkesave dhe të detyrave, në kuadër të këtyre grupeve, në raport me pjesën që ajo përfaqëson dhe kryen funksionet e saj në përputhje me parashikimet e marrëveshjes kuadër dhe rregulloret e tjera përkatëse të BE-së për këtë qëllim. Në këto raste, drejtori ka kompetenca vetëm mbi dakordësimin e kushteve të pjesëmarrjes me kryesuesin e grupit përkatës, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit Mbikëqyrës.

8. Agjencia bashkëpunon dhe koordinon, sipas rastit, me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë për të siguruar auditim efektiv të bashkëfinancimit të dhënë nga Buxheti i Shtetit, si pjesë e projekteve të Bashkimit Evropian.

9. Kur është e përshtatshme, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, Agjencia mund të mbështetet në punën e audituesve të brendshëm të strukturave IPA pranë institucioneve përfituese. Për të përfshirë këtë aktivitet të auditimit të brendshëm në planifikimin e saj, Agjencia ka të drejtë të kërkojë detajet e punës së kryer nga auditimi i brendshëm, përfshirë raportet dhe dosjet e auditimit të brendshëm në çdo njësi të auditimit të brendshëm që është e përfshirë në auditimin e fondeve të IPA-s.

KREU III

KOMPETENCAT, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 23

Planifikimi i auditimit

1. Agjencia kryen veprimtaritë dhe auditimet në përputhje me dokumentet strategjike dhe

planifikuese të auditimit dhe, në veçanti, me Strategjinë e Auditimit, siç përcaktohet në nenin 8, të këtij ligji.

2. Agjencia, si autoritet i pavarur i auditimit, harton planin e saj të auditimeve, në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve kuadër aktuale, rregulloret e KE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

3. Gjatë planifikimit të auditimit, Agjencia duhet të jetë e pavarur nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe nga të gjitha organet dhe njësitë e tjera të përfshira në menaxhimin dhe zbatimin e veprimtarive të financuara nga BE-ja.

4. Strategjia e Auditimit përcakton metodo-logjinë e auditimit, metodat e përzgjedhjes për auditimin e operacioneve e të transaksioneve dhe për planifikimin e auditimeve.

Strategjia përgatitet në bazë vjetore dhe duhet të mbulojë tri vitet e ardhshme financiare, sipas kër-kesave dhe formës së përcaktuar në marrëveshjen kuadër përkatëse, si dhe rregulloreve e udhëzimeve të nxjerra nga Komisioni Evropian për zbatimin e këtyre kërkesave.

5. Strategjia e Auditimit është baza për përcaktimin e kërkesave për burime nga buxheti i shtetit dhe/ose burime të tjera, si dhe për vendo-sjen e prioriteteve të Agjencisë për programin e punës, shpërndarjen e këtyre burimeve, si dhe nevojën për shërbime që mund të kontraktohen nga palë të treta jashtë saj.

Neni 24

Kryerja e auditimeve

Agjencia, duke vepruar si autoritet i auditimit, kryen auditime në përputhje me Strategjinë e Auditimit dhe planet vjetore të punës, në të gjitha fushat dhe pranë njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe personave fizikë dhe/ose juridikë privatë që:

a) janë përfitues ose konsiderohen përfitues të fondeve nga Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA);

b) kanë pranuar detyrimet për kryerjen e veprimtarive që rrjedhin nga pjesëmarrja në programet apo projektet IPA.

Neni 25

Llojet e auditimeve

1. Agjencia kryen auditime sipas kërkesave të legjislacionit të brendshëm, marrëveshjeve kuadër dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Këto auditime përfshijnë:

a) auditimet e sistemeve, që kanë si qëllim dhënien e sigurisë se sistemet e drejtimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, funksionimi i këtyre sistemeve në organet e deleguara, auditimet e brendshme, organizimi i kontabilitetit dhe menaxhimit financiar janë vendosur dhe operojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjet kuadër dhe rregulloret e aplikueshme të KE-së;

b) auditimet e operacioneve, që kanë si qëllim të ofrojnë siguri për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të pasqyruara në deklaratat financiare të paraqitura pranë Komisionit Evropian;

c) auditimet e përputhshmërisë, që kanë si qëllim ofrimin e sigurisë mbi pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat operacionale të IPA-s, si dhe me legjislacionin kombëtar;

ç) auditimet e performancës, që kanë si qëllim ofrimin e një vlerësimi të pavarur dhe objektiv të funksionimit të programeve, proceseve dhe veprimtarive të strukturave të IPA-s, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;

d) auditimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që kanë për qëllim dhënien e sigurisë se këto sisteme funksionojnë në mënyrë efektive, brenda një mjedisi të përshtatshëm kontrolli dhe ofrojnë rezultatet e pritshme.

2. Agjencia mund të kryejë angazhime të sigurisë së kufizuar sipas udhëzimeve të INTOSAI-t. Agjencia, me kërkesë të Zyrtarit Kombëtar të Autorizuar, lejohet të kryejë vlerësime të pajtueshmërisë, për të cilat nevojitet një opinion i auditimit të jashtëm, në mbështetje të kërkesës për transferimin e detyrave të zbatimit të buxhetit. Vlerësimet e pajtueshmërisë kryhen nga një grup

auditues, i ndryshëm nga grupi i auditimit që ka qenë i përfshirë në auditimet e zakonshme brenda njësive/subjekteve të audituara.

3. Agjencisë i lejohet të ofrojë asistencë teknike ose profesionale për të tjera autoritete auditimi të IPA-s apo njësive të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, kundrejt pagesës, pas marrjes së miratimit paraprak të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë.

4. Llojet dhe masa e tarifave për shërbimet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, dhe përdorimi i të ardhurave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26

Të drejtat e Agjencisë

1. Agjencia, në përputhje me funksionin e saj, ka autoritetin:

a) të auditojë të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, personat fizikë dhe juridikë, privatë, të cilët janë të përfshirë direkt ose indirekt në menaxhimin ose zbatimin e mbështetjes/asistencës së Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë ose janë përfitues të kësaj mbështetjeje;

b) të auditojë, në bashkëpunim me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, shpërndarjen e burimeve dhe zërat buxhetorë për çdo njësi, pjesë e bashkëfinancimit të asistencës së BE-së;

c) të përgatitë dhe të japë opinione auditimi, raporte, gjetje dhe rekomandime përkatëse të nevojshme, sipas formës së specifikuar, nga Komisioni Evropian përmes marrëveshjeve kuadër ose rregulloreve të tjera përkatëse;

ç) të japë opinione të auditimit, raporte, gjetje dhe rekomandime drejtpërdrejt pranë subjekteve të audituara, pa iu nënshtruar një procesi të ndërmjetëm kontrolli ose miratimi paraprak;

d) të zbatojë çdo qasje dhe teknikë auditimi që konsiderohet nga Agjencia se është në përputhje me funksionin e saj, me praktikat më të mira, sipas përcaktimeve të organizatave INTOSAI ose IFAC dhe me kërkesat ose rregulloret e zbatueshme të Komisionit Evropian;

dh) të përshtatë, të përmirësojë ose të ndryshojë teknikat e saj audituese, manualet dhe metodologjitë, me qëllim përditësimin sipas kërkesave të standardeve të auditimit dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit;

e) të dërgojë raportin e auditimit me gjetjet përkatëse për komente pranë subjektit të audituar. Në rastet kur subjekti i audituar nuk pranon plotësisht ose pjesërisht gjetjet dhe/ose rekomandimet dhe Agjencia nuk i pranon argumentet e subjektit të audituar, ky i fundit mund:

i) të paraqesë kërkesën për një takim me Agjencinë, me praninë e ZKA-së, për të diskutuar gjetjet, rekomandimet dhe fushat e mos-marrëveshjes. Agjencia ruan të drejtën që t'i përmbahet gjetjeve apo rekomandimeve fillestare;

ii) të kërkojë që rekomandimet apo gjetjet të rishikohen nga një ekspert i pavarur. Në cilësinë e ekspertëve të pavarur, për të kryer procedurën e rishikimit, mund të jenë vetëm kryetarët e autoriteteve audituese të vendeve të tjera kandidate;

ë) të bëjë kërkime, takime, hetime dhe të ketë akses ndaj çdo personi zyrtar, personi juridik apo privat që Agjencia i konsideron të nevojshme për kryerjen e funksionit të saj audituese.

2. Agjencia, para fillimit të auditimit, mund t'i kërkojë subjektit që t'i jepen informacione që konsiderohen të nevojshme për kryerjen e auditimit, përfshirë dokumente, të dhëna ose shpjegime. Pala e audituar duhet t'i përgjigjet kërkesës brenda afatit kohor të specifikuar në njoftim.

3. Agjencia ka të drejtë të përcaktojë llojin e auditimit, dokumentet, informacionet, zyrtarët dhe persona të tjerë që vlerësohet se kanë informacionin e nevojshëm për procesin e auditimit.

Neni 27

E drejta për akses në dokumentet zyrtare

1. Në kryerjen e detyrave të saj, Agjencia ka të drejtën për të pasur akses të lirë dhe të pakufizuar në:

a) të gjitha ambientet e njësisë, subjekt auditimi nga ana e Agjencisë;

b) të gjitha informacionet, librat e llogarive dhe ditarët, të dhënat financiare, informacionet kontraktuale ose të dhëna të tjera, në formë të shkruar dhe/ose në formë elektronike, të nevojshme për kryerjen e funksionit auditues.

2. Subjektet e audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Agjencisë akses në dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave, si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara, të parashikuara në këtë ligj, që mund të përbëjnë "sekret shtetëror" apo "konfidencial" dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës dhe të këtij ligji.

3. Çdo person fizik apo juridik, subjekt auditimi, nuk ka të drejtë të refuzojë dhënien e informacionit, duke iu referuar auditimeve të mëparshme, kontrolleve nga njësitë e tjera ose sekretit bankar, si dhe informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" ose sekret profesional për fushën, objekt auditimi, dhe vetëm për personin e tij.

Neni 28

Ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekretit shtetëror

1. Në rast se Agjencia, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj, përballet me dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike dhe çdo informacion tjetër që përbën "sekret shtetëror", sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", Agjencia duhet të ruajë sekretin në lidhje me:

a) të gjitha konstatimet, dëshmitë e auditimit, informacionet e mbledhura gjatë veprimtarisë audituese, përveç rasteve kur lejohet nga legjislacioni në fuqi;

b) veprimtarinë e të audituarit, përveç rasteve kur Agjencia merr miratimin paraprak me shkrim të të audituarit.

2. Agjencia është e detyruar të ruajë sekretin e informacioneve të tjera dhe të dokumentacionit, të siguruara për shkak të detyrës, përveç raporteve të përcaktuara në këtë ligj dhe rasteve kur ky informacion e dokumentacion duhet të paraqitet si provë në një proces gjyqësor.

Neni 29

Auditimi i veprimtarive "sekret shtetëror"

Veprimtaritë, që përbëjnë "sekret shtetëror", bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, duhet të auditohen nga audituesë të autorizuar nga drejtori i Agjencisë , të cilët duhet të kenë certifikatën e sigurisë, të lëshuar nga institucioni përkatës.

Neni 30

Detyrimet e Agjencisë

Në kryerjen e funksionit të saj, Agjencia duhet:

a) të veprojë në përputhje me të gjitha marrëveshjet kuadër dhe rregulloret e përcaktuara nga Komisioni Evropian dhe të miratuara nga Republika e Shqipërisë për kryerjen e auditimeve të fondeve të BE-së;

b) të përgatitë opinionet, raportet, gjetjet dhe rekomandimet brenda afateve kohore të përcaktuara dhe në format e specifikuara në marrëveshjet kuadër dhe/apo rregulloret e përcaktuara nga Komisioni Evropian;

c) të sigurojë që të gjitha proceset e auditimit janë kryer në përputhje me standardet më të larta profesionale që pasqyrojnë praktikat më të mira ndërkombëtare, standardet e organizatave INTOSAI dhe/ose IFAC, sipas rastit;

ç) të kryejë auditime me objektivitet dhe korrektësi, në përputhje me standardet profesionale të zbatueshme nga institucionet supreme të auditimit që veprojnë në bazë të standardeve të sjelljes, metodologjive dhe pavarësisë së organizatës INTOSAI;

d) të zbatojë Kodin e Etikës për audituesit, bazuar në standardet e organizatës INTOSAI;

dh) të raportojë objektivisht dhe në mënyrë të saktë përfundimet e veprimtarisë së auditimit të kryer, parregullsitë, shkeljet dhe dëmet e konstatuara, shkaqet e ndodhjes së tyre, në bazë të fakteve e të rrethanave të kontrolluara zyrtarisht nga audituesit;

e) të sigurojë rritjen e rolit të Agjencisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të reputacionit të saj;

ë) të përgatitë opinionet, raportet, gjetjet dhe rekomandimet, kur këto janë përfundimtare, në gjuhët anglisht dhe shqip.

Neni 31

Komente mbi projektraportin

1. Përpara nxjerrjes së raportit përfundimtar të auditimit, subjektit të audituar duhet t'i krijohet mundësia për të paraqitur komentet mbi projektraportin.

2. Komentet dhe shpjegimet e bëra i dërgohen Agjencisë brenda 15 ditëve nga data e marrjes së projektraportit. Komentet dhe qëndrimi i audituesve ndaj tyre duhet të pasqyrohen në raportin përfundimtar.

Neni 32

Rekomandimet e Agjencisë dhe zbatimi

1. Në raportet e saj, Agjencia jep rekomandime në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

2. Agjencia informon njëkohësisht subjektin e audituar dhe Zyrtarin Kombëtar të Autorizuar për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga Agjencia brenda sistemit IPA.

3. Agjencia vendos një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe informohet nga Zyrtari Kombëtar i Autorizuar dhe subjektet e audituara për planin e masave për zbatimin e rekomandimeve brenda 15 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të raportit përfundimtar të paraqitur nga Agjencia.

Neni 33

Mashtrimet dhe parregullsitë

1. Nëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese Agjencia krijon dyshimin e arsyeshëm për ekzistencën e mashtrimit, mashtrimit të dyshuar ose një parregullsie të paraportuar më parë, Agjencia duhet të veprojë si më poshtë:

a) në rastin e mashtrimit apo mashtrimit të dyshuar, në përputhje me procedurat e përcaktuara në manualin e Agjencisë, të informojë autoritetet, ZKA-në dhe AFCOS-in, se një mashtrim ka ndodhur ose dyshohet të ketë ndodhur;

b) në rastin e një parregullsie të paraportuar, të informojë ZKA-në dhe të përfshijë zbatimin e rekomandimeve në planifikimin e auditimit;

c) në rrethanat kur Agjencia mendon se parregullsia gjithashtu përfshin ZKA-në, Agjencia mund ta referojë çështjen në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë AFCOS-it dhe pranë ministrit të Financave.

2. Në të gjitha rastet, drejtori, në formulimin e opinionit përfundimtar të auditimit, duhet të marrë parasysh të gjithë rrethanat, faktet dhe dokumentacionin e shqyrtuar gjatë auditimit.

3. Punonjësi i Agjencisë ka detyrimin për të informuar drejtorin për çdo fshehje të dyshimeve të arsyeshme për mashtrim, mashtrim të dyshuar dhe parregullsi të zbuluara gjatë veprimtarisë së auditimit të Agjencisë.

4. Në rastet kur drejtori është i përfshirë në fshehjen e dyshimeve të arsyeshme për mashtrim, mashtrim të dyshuar dhe parregullsi, të zbuluara gjatë veprimtarisë audituese, çdo punonjës i Agjencisë informon drejtpërdrejt autoritetet, ZKA-në dhe AFCOS-in.

5. Punonjësit e Agjencisë në këtë rast i nënshtrohen mbrojtjes së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 34

Ekspertët e përkohshëm të jashtëm

1. Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së institucionit, Agjencia mund të kontraktojë ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, me qëllim:

a) kryerjen e veprimtarive specifike të auditimit që Agjencia nuk mund të kryejë në kohë;

b) trajnimin e stafit;

c) përmirësimin e metodologjisë e të kapaciteteve të Agjencisë;

ç) kryerjen e vlerësimeve të cilësisë dhe rishikimeve të jashtme, me qëllim përmirësimin e performancës teknike e profesionale të Agjencisë.

2. Ekspertët e jashtëm janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave që sigurojnë gjatë ekspertimit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

3. Ekspertët e jashtëm kryejnë detyrën në përputhje me Kodin e Etikës, rregullat për parandalimin e konfliktit të interesit, rregullat dhe standardet e përgjithshme profesionale të Agjencisë.

4. Procedurat e përzgjedhjes së ekspertëve të jashtëm i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Agjencia mbetet përgjegjëse për të gjitha gjetjet e auditimit, edhe kur ato bazohen në mendimin e ekspertëve të jashtëm.

Neni 35

Publiciteti

1. Agjencia respekton kërkesat për publicitetin dhe vizibilitetin, siç përcaktohet në udhëzimet dhe rregulloret e Komisionit Evropian.

2. Agjencia, në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore për të informuar autoritetet përkatëse dhe palët e përfshira, siguron transparencën e veprimtarisë së saj nëpërmjet:

a) publikimit të raporteve të veprimtarisë vjetore të Agjencisë;

b) publikimit elektronik të përmbledhjes së raporteve të auditimit;

c) konferencave për shtyp dhe mjeteve të tjera mediatike, përveç rasteve kur informacioni konsiderohet si "konfidencial" në përcaktimet e legjislacionit kombëtar dhe evropian përkatës.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 36

Dispozita kalimtare

1. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryeministri emëron anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, drejtori dhe punonjësit e Agjencisë vijojnë të ruajnë pozicionet e tyre me të njëjtat kushte sikurse janë punësuar më parë në Agjenci, në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Neni 37

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 4, 10, pika 6, dhe 25, pika 4.

2. Ngarkohet Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë rregulloret, manualet dhe Kodin e Etikës të Agjencisë.

Neni 38

Shfuqizime

1. Vendimi nr. 1020, datë 14.10.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë për Auditimin e Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore të tjera, të nxjerra në bazë të vendimit nr. 1020, datë 14.10.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.9.2016

Shpallur me dekretin nr. 9752, datë 3.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani